



VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 11 nëntor 2014

Numri i lëndës: 2012-14

Zahiti

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 11 nëntor 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. Vendimi i Panelit i datës 4 shkurt 2014

1. Më 4 shkurt 2014, Paneli ka marrë vendim rreth ankesës së parashtruar nga Valbone Zahiti kundër EULEX-it, në lidhje me një mosmarrëveshje që ajo kishte me një pjesëtar të EULEX-it, që rezultoi me lëndim të ankueses.
2. Paneli ka konstatuar se EULEX-i ka shkelur të drejtën e ankueses në mjet ankimi efektiv, siç garantohet *ndër të tjera* sipas nenit 13 të KEDNj, që ia mundëson asaj të kërkoj dëmshpërblim për dëmin që iu ishte shkaktuar nga një pjesëtar i EULEX-it.

3. Në vendim, Paneli i ka bërë disa rekomandime shefit të Misionit (ShM) sipas rregullës 34 të rregullores së punës, si në vijim:
 - i. ShM duhet të pranoj se të drejtat e ankueses janë shkelur nga EULEX-i. Paneli fton ShM të njoftoj ankuesen për qëndrimin e vet lidhur me atë çështje;
 - ii. ShM duhet të merr parasysh heqjen e imunitetit të ish pjesëtarit të stafit dhe të informoj prokurorin vendor të Kosovës në përputhje me rrethanat;
 - iii. Nëse është e nevojshme përmes EEAS (Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm), ShM duhet t'i informoj autoritetet shtetërore të shtetit dërgues rreth gjetjeve të Panelit;
 - iv. Duke marrë parasysh parashtrimet nga ShM lidhur me disponueshmërinë që ka ankuesja në kërkesat ndaj palës së tretë dhe nëse ShM konsideron se këtij rasti mund t'i ofrohet zgjidhja në atë skemë, Paneli rekomandon se ShM duhet të ftojë ankuesen që të paraqesë një kërkesë tek ajo skemë.
4. Vendimi i tanishëm përbën një vazhdimësi të vendimit të Panelit të datës 4 shkurt 2014 dhe rekomandimeve të bëra në të. Kompetenca dhe autoriteti i Panelit për t'i përcjellë vendimet dhe rekomandimet e veta parashihet në rregullën 45 e tutje të rregullores së punës së Panelit (shih p.sh. vendimet për zbatimin e rekomandimeve W kundër EULEX-it, 2011-07, 26 gusht 2014; H&G kundër EULEX-it, 2012-19&20, 27 maj 2014, A,B,C&D kundër EULEX-it, 2012-09, 2012-10, 2012-11 & 2012-12, 5 shkurt 2014; W. kundër EULEX-it, 2011-07, 25 nëntor 2013; Djeljalj Kazagic kundër EULEX-it, 2010-01 23 nëntor 2011 dhe Blerim Rudi kundër EULEX-it, 2010-07, 23 nëntor 2011).

II. INFORMATAT E MARRA NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

5. Më 2 prill 2014, shefi i Misionit ka informuar Panelin sa i përket një numër masash që i kishte ndërmarrë në lidhje me rekomandimet e Panelit.
6. Në veçanti, shefi i Misionit ka pohuar se kishte qëllim që t'i informoj autoritetet e shtetit dërgues të pjesëtarit të EULEX-it në fjalë në lidhje me gjetjet e Panelit.
7. Më tej, shefi i Misionit ka informuar Panelin se ishte tepër vonë për ta referuar çështjen e ankueses tek sigurimi i kërkesës për kompensim palës së tretë të Misionit. Megjithatë, ShM ka treguar se Misioni do ta kontaktoj ankuesen drejtpërdrejt për ta vazhduar më tutje çështjen me ankuesen në mënyrë që të kërkohet të arrihet një marrëveshje e përbashkët.
8. Më 6 qershor 2014, shefi i Misionit ka informuar Panelin mbi hapat e saktë të ndërmarrë në lidhje me secilin prej rekomandimeve të Panelit. Në lidhje me rekomandimin se ShM duhet të pranoj se të drejtat e ankueses ishte shkelur nga EULEX-i dhe të informoj ankuesen rreth qëndrimit të tij sa i përket asaj çështjeje, ShM ka informuar se njësitë përkatëse dhe Komandanti Civil i

Operimeve kanë qenë të angazhuar rreth diskutimeve në lidhje me implikimet e mundshme të gjetjeve të Panelit. Në lidhje me këtë është pohuar se janë studiuar skemat e sigurimeve dhe se është bërë një hulumtim krahasues i sistemeve të tjera të organizatave ndërkombëtare. Përveç kësaj, është hartuar një memorandum shpjegues në Njësinë e Hetimeve të Brendshme që në të ardhmen të zbatohen praktikat më të mira në rast të ndonjë viktime të jashtme në ndonjë incident, që hetohet nga Njësia e Hetimeve të Brendshme. Nga parashtrimet e ShM rreth kësaj çështje shihet se Misioni nuk e ka zbatuar këtë rekomandim të Panelit.

9. Në lidhje me rekomandimin që të hiqet imuniteti i pjesëtarit të stafit dhe të informohet prokurori vendor i Kosovës siç duhet, ShM ka treguar se ShM i mëparshëm i EULEX-it kishte kërkuar në qershor të vitit 2012 nga prokurori vendor i Kosovës që së pari të kontaktoj autoritetet shtetërore të pjesëtarit të EULEX-it në fjalë në lidhje me hetimin e mundshëm dhe procedurat në shtetin dërgues dhe më pas të informoj Misionin rreth statusit të lëndës në mënyrë që konsideroj nëse pjesëtarit në fjalë duhet t'i hiqet imuniteti. Pasi që EULEX-i asnjëherë nuk ka marrë ndonjë informacion apo kontakt tjetër nga prokurori i Kosovës, ShM ka vendosur që pjesëtarit në fjalë mos t'ia heqë imunitetin.
10. Në lidhje me rekomandimin që të informohen autoritetet shtetërore të pjesëtarit të EULEX-it në fjalë lidhur me vendimin dhe gjetjet e Panelit, ShM ka informuar se më 23 prill 2014, ai e kishte dërguar këtë informacion tek ato autoritete.
11. Në lidhje me rekomandimin që të ftohet ankuesja ta paraqes një kërkesë në sigurimin e përgjegjësisë ndaj palës së tretë, ShM ka vënë në dukje si në vijim: Incidenti ka ndodhur në vitin 2011 dhe afati kohor për të paraqitur kërkesë në sigurim është e caktuar të jetë dy vjet; sigurimi në kohën e incidentit ishte në emër të ShM të mëparshëm, dhe duket se ankuesja nuk ka pësuar asnjë dëm në para që mund të kompensohet nga sigurimi. Mbi këtë bazë, ShM ka gjetur të pamundur që të zbatohet ky rekomandim i Panelit.
12. Më 30 shtator 2014, ShM ka informuar Panelin se diskutimet me ankuesen për të gjetur zgjidhje alternative rreth rastit të saj nuk kishin dhënë ndonjë rezultat pozitiv.

III. VLERËSIMI NGA PANELI

13. Paneli vëren hapat e ndërmarrë nga ana e ShM për t'i zbatuar disa prej rekomandimeve të Panelit.

Pranimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut

14. Si në vendimet e mëparshme, Paneli vëren se ShM nuk e ka pranuar zyrtarisht shkeljen e të drejtave të njeriut të ankueses dhe nuk e ka informuar

zyrtarisht ankuesen për qëndrimin e tij rreth asaj çështjeje, përkundër rekomandimit të Panelit për të.

15. Paneli vëren edhe një herë (shih *H&G kundër EULEX-it*, 2012-19&20, 27 maj 2014, në paragrafët 11-13) se pranimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut nga autoritetet përgjegjëse është praktikë e njohur në jurisprudencë, *ndër të tjera*, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (shih rregullën 62 A të rregullores së Gjykatës). Një praktikë e ngjashme rreth pranimin të shkeljeve të të drejtave të njeriut është zbatuar rregullisht nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) i UNMIK-ut (shih për shembull, në PKDNj vendimin e fundit gjerë më sot, *MITIC kundër UNMIK-ut*, lënda nr. 064/09 i datës 14 mars 2014 në par. 43).
16. Duke pasur parasysh faktin se Paneli nuk mund të rekomandojë që t'i paguhet viktimës kompensim monetar, Paneli ka ftuar ShM që t'i shfrytëzojë mjetet juridike në dispozicion të tij. Në disa raste, pranimi formal i shkeljes së të drejtave e mundëson ofrimin e një kompensimi për viktimën. Duke marrë parasysh kufizimet e vendosura në kompetencat e Panelit për të rekomanduar kompensim financiar, siç përcaktohet nga Koncepti Llogaridhënës i EULEX-it i datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, pranimi formal i një shkeljeje nga autoriteti kompetent bëhet mbi të gjitha si formë kompensimi.
17. Paneli vëren me keqardhje vendimin e ShM për të mos shfrytëzuar mundësinë që ankueses t'i ofroj një shkallë kompensimi duke e pranuar shkeljen e të drejtave që ajo i ka vuajtur.

Heqja e imunitetit të ish pjesëtarit

18. Lidhur me rekomandimin se ShM duhet të konsideroj heqjen e imunitetit të ish pjesëtarit dhe të informoj prokurorin vendor të Kosovës siç duhet, ShM ka pohuar se prokurori vendor i Kosovës ishte dashur që së pari të kontaktonte autoritetet shtetërore të ish pjesëtarit të EULEX-it në fjalë dhe më pas të informonte Misionin për statusin e lëndës në mënyrë që të merrte në konsideratë heqjen e imunitetit të pjesëtarit të EULEX-it. Pasi që EULEX-i nuk ka marrë ndonjë informacion të mëtejshëm në këtë drejtim, ShM nuk e ka konsideruar të nevojshme për ta hequr imunitetin.
19. ShM ka nuk ka ofruar asnjë shpjegim bindës dhe asnjë bazë ligjore sa i përket qëndrimit se pse heqja e atij imuniteti ishte kërkuar në rend të parë ose ishte e varur prej ekzistimit të një hetimi të atij rasti nga autoritetet shtetërore të ish pjesëtarit të EULEX-it në fjalë. Kjo vijë e argumentit nuk është e arsyeshme, pasi çdo hetim i mundshëm i autoriteteve shtetërore ndaj pjesëtarit të EULEX-it me gjasë do të kërkonte heqjen e imunitetit të ish pjesëtarit të EULEX-it.
20. Në rend të parë heqja e imunitetit nga ana e Misionit mund të ofroj vetëm nxitje për autoritetet vendore që të vendosin ta hapin një hetim të tillë. Në të kundërtën, sugjerimi i ShM se për çfarëdo vendimi për heqjen e imunitetit duhet një kërkesë zyrtare nga autoritetet shtetërore nuk është e arsyeshme

dhe vështirë se kontribuon në kompensimin efektiv të dëmit që ju është shkaktuar ankueses. Në një skenar të tillë, autoritetet shtetërore do të duhet që së pari të kërkojnë heqjen e imunitetit nga ShM para se të jenë në gjendje të fillojnë me hetimin e tyre, e cila mund ta vonoj atë edhe më tutje, dhe ShM nuk do të jetë në pozitë më të mirë sesa që është sot për të vendosur që ta heqë atë imunitet.

21. Për më tepër, një vendim për të hequr këtë imunitet do të dërgonte një porosi të qartë dhe pa asnjë dyshim se Misioni nuk i fal aktet e tilla dhe nuk do ta lë që imuniteti i Misionit të kontribuojë në krijimin e papërgjegjësisë kundrejt shkelje të rënda të të drejtave.
22. Prandaj, Paneli vëren me keqardhje vendimin e ShM që mos ta heq imunitetin e ish punonjësit të vet, dhe për më tepër vëren që ShM nuk zbaton këtë rekomandim të Panelit.

Informimi i autoriteteve të shtetit dërgues

23. Paneli është i sigurt se ShM ka zbatuar rekomandimin e tij për të informuar autoritetet shtetërore të shtetit dërgues rreth gjetjeve të Panelit.

Disponueshmëria e sigurimit të kërkesës për kompensim ndaj palës së tretë

24. Paneli vëren parashtrimet e ShM sa i përket këtij rasti se sigurimi i kërkesës për kompensim ndaj palës së tretë nuk është në dispozicion.
25. Paneli pranon se, në këtë moment, ShM nuk është më në gjendje ta ftoj ankuesen të paraqesë ndonjë kërkesë në sigurimin e përgjegjësisë ndaj palës së tretë. Megjithatë, Paneli vëren se gjatë parashtrimeve të tij, EULEX-i iu kishte referuar sigurimit të kërkesës për kompensim ndaj palës së tretë si një rrugë e mundshme për ankuesen në mënyrë që të kërkonte ndihmë për dëmin që ju ishte shkaktuar asaj. Duke pasur parasysh se ky mjet në të vërtetë nuk ishte në dispozicion të saj, Paneli do të kishte preferuar që Misioni mos t'i referohet këtij mekanizmi, pasi që në fakt ai nuk ishte i zbatueshëm për rastin në fjalë.
26. Së fundi, Paneli lavdëron përpjekjet e ShM për t'u angazhuar edhe më tej me ankuesen në mënyrë që të kërkohet që të trajtohen ankesat e saj edhe pse në këtë rast këto përpjekje kanë dalë të jenë të pasuksesshëm.

PANELI NJËZËRI

Deklaron se ShM ka zbatuar disa nga rekomandimet e Panelit dhe nuk i ka zbatuar rekomandimet e tjera.

Lidhur me ato rekomandime, të cilat nuk janë zbatuar, Paneli fton ShM edhe një herë që të rishikoj qëndrimin e tij sa i përket mundësisë së pranimit të shkeljes së të drejtave të ankueses nga ana e Misionit dhe ta konsideroj heqjen e imunitetit të pjesëtarit të EULEX-it.

Vendos që ta mbyll shqyrtimin e kësaj lënde.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese